



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 25.6.2019

Lënda: Parashtrime të Komisionerit Publik Florian Ballhysa, në seancën gjyqësore të datës 25.6.2019, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në çështjen ankim kundër vendimit nr. 46, datë 24.7.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Xhezair Zaganjori, gjyqtar/kryetar i Gjykatës së Lartë

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5, i Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë (IKP), më datë 28.9.2018, është njoftuar vendimi nr. 46, datë 24.7.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Xhezair Zaganjori, gjyqtar/kryetar i Gjykatës së Lartë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi vlerësoi dhe rekomandimin përkatës të paraqitur nga një komisioni prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të ONM-së, brenda afatit 15-ditor nga njoftimi i vendimit, ka ushtruar ankim.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Xhezair Zaganjori, në mbështetje të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës, dhe në zbatim të nenit 4, pika 4 të ligjit nr. 84/2016, i është nënshtuar procesit të rivlerësimit *ex officio* dhe më përparësi në kohë.

2. Mbështetur në pikën 1 të nenit Ç, të aneksit të Kushtetutës, procesi i rivlerësimit për subjektin z. Xhezair Zaganjori ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kritereve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Nisur nga rezultatet e hetimit për secilin kriter dhe nga provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni bazuar në germën “a”, të pikës 1, të nenit

58, pika 1 e nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Xhezair Zaganjori. Ndaj këtij vendimi është ushtruar ankim nga Komisioneri Publik.

Duke i qëndruar të gjitha shkaqeve të parashtruara në ankimin e Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 46, datë 24.7.2018, parashtrojmë si vijon:

II. A Vlerësimi i Komisionerit Publik mbi interpretimin ligjor të Komisionit

3. Komisioneri Publik konstaton se në arritjen e përfundimit për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit z. Zaganjori, *Komisioni* është mbështetur në disa arsyetime dhe qëndrime jo të sakta, lidhur me kuptimin dhe zbatimin e dispozitave kushtetuese dhe ligjeve të posaçme, qëndrime këto, të cilat meritojnë vëmendje nga ana e *Kolegjit*.

4. Komisioneri Publik nuk ndan të njëjtin qëndrim me sa parashtron dhe konkludon *Komisioni*¹ lidhur me interpretimin e nenit D të aneksit të Kushtetutës, pikat 3 dhe 4 të tij, për sa i përket: (i) burimit të ligjshëm të pasurisë; (ii) Deklaratës Vetting në raport me deklaratimet ndër vite; (iii) trajtimin që *duket se* i bën pikës 3 dhe 4 të nenit D të aneksit të Kushtetutës, duke i konsideruar me natyrë *kumulative*.

4.1. *Komisioni* lidhur me (i) burimin e ligjshëm, ndër të tjera, arsyeton se [...] *mospagimi i detyrimeve fiskale, pa vërtetuar paligjshmërinë e pasurisë, nuk mundet të shërbejë si shkak për dhënien e masave disiplinore në bazë të kësaj dispozite kushtetuese dhe dispozitave ligjore të dala në zbatim të saj[...]*².

4.1.1 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, dispozita kushtetuese e pikës 3, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, kur sanksionon “*Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat ...për të cilat janë paguar detyrimet tatimore*”, jep parimin mbi bazën e të cilit duhet të veprohet në rastin e “*kualifikimit*” të pasurisë si të ligjshme, duke referuar te normat ligjore në fuqi, që normojnë marrëdhëniet, të cilat lindin në fushën e tatimeve. Ligji në fuqi është ai me nr. 8438/viti 1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, i cili, në dy dispozita të tij, përcakton se cilat janë *të ardhura të tatueshme* (neni 8) dhe cilat janë *të ardhura të përjashtuara/të patatueshme* (neni 9). Sipas këtyre dispozitave ligjore, në zbatim të pikës 3 nenit D të Kushtetutës, e ardhur e ligjshme do të jetë ajo e ardhur për të cilën provohet se është paguar detyrimi tatimor ose ato të ardhura për të cilat dispozita ligjore në fuqi i ka përjashtuar nga detyrimi për pagimin e tatimit. Pra, ligji është “*kualifikuesi*” më i saktë i atyre rasteve kur mospagimi i tatimit për shkak përjashtimi ligjor nuk do të përbëjë shkak për kalimin e barrës së provës dhe mundësisë për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, deklarimi i pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë. Zbatimi i pikës 4 të nenit D, në vlerësimin e Komisionerit Publik ka një rrjedhë të tillë hapash në rend kronologjik. Subjektet e rivlerësimit

¹ Faqe 27, 29 dhe 30 të vendimit.

² Faqe 27 e vendimit.

deklarojnë pasuritë e tyre. Nga kontrolli i bërë këtyre pasurive rezulton se subjektet deklarojnë për to si aktin/burimin e krijimit, i cili është i ligjshëm, ashtu edhe detyrimet ligjore që janë përmbushur, pra i plotëson të dyja kushtet në mënyrë *kumulative*:

- Bazohet në burim/akt të ligjshëm (për shembull, kontratë pune, kontratë shitje, kontratë qiraje, kontratë dhurimi, kontratë shkëmbimi etj.)
- Sipas rastit, detyrimi tatimor është paguar ose është i përjashtuar.

4.2. *Komisioni*, lidhur me (ii) Deklarata Vetting në raport me deklarimet ndër vite, ndër të tjera, arsyeton se: [...] *Në lidhje me vlerësimin e pasurisë, në zbatim të nenit D të Kushtetutës, këto organe kanë si objekt të vlerësojnë nëse subjektet e rivlerësimit kanë fshehur pasuri (nuk e kanë deklaruar atë) apo nuk justifikojnë ligjërisht pasuritë e deklaruara dhe, për efekt të këtij procesi, subjektet e rivlerësimit do të plotësonin një deklaratë të re, të detajuar dhe gjithëpërfshirëse të pasurisë së tyre, burimeve të krijimit të kësaj pasurie dhe dokumenteve justifikuese (shih nenin D të aneksit të Kushtetutës dhe nenin 30 dhe 31 të ligjit nr. 84/2016). Pra, objekt kontrolli nga ana e organeve të rivlerësimit në kuadër të këtij procesi do të ishte vetëm Deklarata Vetting dhe jo deklarimet e bëra ndër vite nga subjektet e rivlerësimit. Kjo do të thotë se vlerësimin nëse ka pasur mosdeklarim apo mosjustifikim të pasurisë nga subjektet e rivlerësimit, këto organe, sipas ligjit, do ta bënin ekskluzivisht vetëm në raport me Deklaratën Vetting dhe jo në raport me deklarimet ndër vite të funksionarëve publikë, sipas ligjit për deklarimin e pasurive. Në të kundërt, nuk do të kishte kuptim detyrimi kushtetues dhe ligjor i subjektit të rivlerësimit që të bënte një vetëdeklarim të ri, gjithëpërfshirës dhe të detajuar të pasurisë, me qëllim rivlerësimin kalimtar të tyre, por do të mjaftonte që organet ad hoc të rivlerësimit të mblidhnin deklaratat ndër vite të këtyre subjekteve dhe të vlerësonin nëse ka shkelje të ligjit nga ana e tyre apo jo në lidhje me deklarimin e pasurive.[...]*³

4.2.1 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, dispozita kushtetuese e pikës 2, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, kur sanksionon: “*Subjekti i rivlerësimit dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar...*”, jep **renditjen e provave**, nga ku duhet të fillojë hetimi administrativ për kontrollin e pasurisë, por nuk përbën, nënkupton **shkakun** e vetëm mbi bazën e të cilit merret vendimi i Komisionit. Duke qenë **njëra nga provat**, ashtu sikurse aktet e tjera të administruara gjatë procesit të përcaktimit të gjendjes së fakteve dhe rrethanave, që kanë lidhjen me çështjen (neni 49 i ligjit nr. 84/2016) nuk ka mbivlerë, pra natyrë prevalue mbi provat e tjera, sikurse janë edhe deklarimet e interesave private dhe pasurore, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja, për shkak të urdhërimit ligjor përkatës.

4.2.2. Zbatimi i pikës 2, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, ka qenë objekt i çështjeve të shqyrtuara nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, për të cilën ka vendimmarrje dhe është krijuar

³ Faqe 29 dhe 30 e vendimit

jurisprudencë⁴, e cila në kuptim të Komisionerit Publik ka të përbashkët arsyetimet se Deklarata Vetting nuk qëndron e vetme gjatë procedurës së vlerësimit të kriterit të kontrollit të pasurisë.

4.3. *Komisioni*, lidhur me (i) trajtimin që duket se i bën pikës 3 dhe 4, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, duke i konsideruar me natyrë *kumulative*, ndër të tjera, arsyeton se: [...] *Në këtë kuptim, Komisioni vlerëson se juridiksioni kushtetues dhe ligjor i saj kushtëzohet dhe mjaftohet me kontrollin e Deklaratës Vetting të subjektit të deklarimit... Kjo do të thotë se subjekti i rivlerësimit nuk ka fshehur apo ka deklaruar çdo të ardhur të detyrueshme nga ligji për t'u deklaruar në Deklaratën e Pasurisë - Vetting. Kjo do të thotë se pika 3 e nenit D të Kushtetutës, në pjesën e prezumimit absolut të fajësisë së subjektit të rivlerësimit, konkretisht në pjesën e mosdeklarimit apo fshehjes së pasurisë, është irrelevante në çështjen objekt gjykimi. Lidhur me prezumimin relativ ligjor të ligjshmërisë së burimeve të krijimit të të ardhurave të subjektit të rivlerësimit, konkretisht pjesa tjetër dhe kumulative e pikës 3 dhe 4, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, Komisioni vlerëson se, ashtu sikurse ka konkluduar edhe më sipër në arsyetimin e këtij vendimi, subjekti dhe bashkëshortja, apo thënë ndryshe bashkësia ligjore ndër vite, ka pasur likuiditete dhe të ardhura të mjaftueshme dhe të krijuara në mënyrë të ligjshme sa për të mbuluar shpenzimet [...]*⁵

4.3.1 Në vlerësimin e Komisionerit Publik arsyetimet e Komisionit nuk qëndrojnë, pasi *prezumimet ligjore absolute të fajësisë* së subjektit të rivlerësimit dhe *prezumimi ligjor relativ i burimit të ligjshmërisë* nuk janë rrjedhojë e parashikimeve të pikës 3 dhe 4, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës. Pika 3 e nenit D vendos detyrimin për subjektin e rivlerësimit, që të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive, ndërsa pika 4 e nenit D parashikon rastin kur subjekti ka një pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme, ai prezumohet fajtor për shkelje disiplinore dhe duhet të paraqesë prova të vërtetojë të kundërtën. Këto parashikime kushtetuese qëndrojnë të pavarura nga njëra-tjetra, por janë komplementare (plotësuese) dhe nuk mund të konsiderohen me natyrë kumulative (pa njërin nuk ekziston tjetra). Zbërthimi i kësaj dispozite kushtetuese është bërë në ligjin nr. 84/2016 dhe gjen pasqyrim në nenin 61, pika 1 dhe 3 e tij. Në nenin 61, masa disiplinore e shkarkimit nga detyra ndaj subjektit të rivlerësimit jepet:

(i) “Kur rezulton se ka deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë, përfshirë edhe personat e lidhur me të” (pika 1), pra sanksionimi kushtetues i pikës 4, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës pasqyrohet në këtë pikë.

(ii) “Kur rezulton se ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit ...pasurisë...” (pika 3), pra sanksionimi kushtetues i pikës 3, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës pasqyrohet në këtë pikë.

Sikurse shihet qartë, neni 61 i ligjit nr. 84/2016, pikat 1 dhe 3 qëndrojnë si raste të veçanta të pavarura nga njëra - tjetra dhe jo kumulative.

⁴ Vendimet e Kolegjit nr. 6,7,8,9, 11, 12, të vitit 2018, nr. 9/2019.

⁵ Faqe 30 e vendimit.

II.B Vlerësimi mbi pasuritë e paluajtshme të subjektit të rivlerësimit

1. Nga aktet në dosje rezulton se subjekti i rivlerësimit ka në bashkëpronësi katër pasuri në zonën kadastrale ***, qyteti Tiranë, rruga “***.***.***”, si më poshtë:

- a. pasuria me nr. ***, në bashkëpronësi me bashkëshorten, sipërfaqe 296 m² (në vijim referuar “Apartament banimi”);
- b. pasuria me nr. ***, në bashkëpronësi 2/8 pjesë⁶, sipërfaqe 260 m² (në vijim referuar “Bodrumi”);
- c. pasuria me nr. ***, në bashkëpronësi 2/8 pjesë, sipërfaqe 281 m² (në vijim referuar “Biblioteka/dyqani”);
- d. pasuria me nr. ***, në bashkëpronësi 2/8 pjesë, sipërfaqe 57 m² (në vijim referuar “Zyrë”).

2. Për këto pasuri, deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në *Deklaratën e personit që mbart detyrim për deklarim pasurie* (këtu e në vijim referuar si DV-2003) krahasuar me *Deklaratën e pasurisë Vetting* (këtu e në vijim referuar si D-Vett.), janë të pasakta dhe të pamjaftueshme për sa i përket (i) vlerës për këto pasuri dhe (ii) burimit të të ardhurave të ligjshme, që kanë shërbyer për krijimin e tyre.

3. Referuar “*Rezultateve paraprake të hetimit administrativ*”, Komisioni, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të gjitha këto pasuri, pasi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm, të pasaktë dhe se nuk ka burime të mjaftueshme për t’i justifikuar ato. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumentacionin përkatës, të cilin e ka konsideruar të mjaftueshëm në kuptim të nenit 52, të ligjit nr. 84/2016.

4. Për vlerën e deklaruar për pasuritë

4.1. Vlera në lekë për këto pasuri, e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në DV-2003 dhe D-Vett., rezulton si në vijim:

DV-2003		D-Vett.	
<i>Pasuria</i>	<i>Vlera në lekë</i>	<i>Pasuria</i>	<i>Vlera në lekë</i>
<i>i. Apartament banimi</i>	7,400,000.00	<i>i. Apartament banimi</i>	5,800,000
<i>ii. Bibliotekë</i>	1,800,000.00	<i>ii. Bibliotekë/Dyqan</i>	1,400,000
<i>iii. Bodrum dhe zyrë</i>	1,500,000.00	<i>iii. Bodrum+zyrë</i>	1,200,000
Total	10,700,000.00		8,400,000

⁶ 2/8 pjesë i referohet pjesëve takuese së bashku me bashkëshorten. Ky shënim vlen edhe për pasurinë referuar “c” dhe “d”.

4.2. Lidhur me pasaktësitë në vlerat e deklaruara konstatojmë se:

(i) Për pasurinë “Apartament banimi”, subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni, parashtron se pasaktësitë midis DV-2003 dhe D-Vett. janë rezultat i mospërfshirjes në këtë të fundit, të vlerës së arredimit prej 1.600.000 lekë⁷. Pasaktësi mbi vlerën e deklaruar evidentohen edhe në shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit në Komision, ku për këtë pasuri deklarohet shuma 9,100,000.00 lekë⁸, 7,400,000.00 lekë⁹, si dhe në *Apelin kundërshtues*¹⁰ shuma 5,800,000.00 lekë.

(ii) Për pasurinë “Bodrum dhe zyrë”, subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni, parashtron se pasaktësitë midis DV-2003 dhe D-Vett. janë si rezultat i mospërfshirjes në këtë të fundit, të vlerës së arredimit prej 300.000 lekë¹¹.

(iii) Për pasurinë “Bibliotekë/dyqan”, subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni, parashtron se pasaktësitë midis DV-2003 dhe D-Vett. janë si rezultat i mospërfshirjes në këtë të fundit, të vlerës së arredimit prej 400.000 lekë¹².

4.3. Përveç sa më sipër, nga aktet në dosje, pasaktësitë në vlera rezultojnë edhe nga 4 kontratat e shitjeve të pasurive të paluajtshme të sipërcituara, të gjitha më datë ****.10.2001*, në të cilat: **(i)** vlera për pasurinë “Apartament banimi”, në bashkëpronësi me bashkëshorten, është 500.000 lekë; **(ii)** vlera për pasurinë “Bibliotekë/dyqan”, në bashkëpronësi 2/8 pjesë, është 125.000 lekë; **(iii)** vlera për pasurinë “Bodrum”, në bashkëpronësi 2/8 pjesë, është 125.000 lekë; **(iv)** vlera për pasurinë “Zyrë”, në bashkëpronësi 2/8 pjesë, është 125.000 lekë.

4.4. Subjekti i rivlerësimit, për sa i përket të ardhurave të cilat kanë shërbyer si burim për krijimin e pasurisë, deklaron se: **(i)** vlera prej 2,500,000.00 lekë është dhënë në vitin 1996¹³ dhe se **(ii)** vlerat prej 1,000,000.00 lekë dhe 1,600,000.00 lekë janë dërguar nga *Gjermania* në vitin 1999¹⁴. Nga aktet në dosje nuk provohet burimi i ligjshëm i të ardhurave të ligjshme, në kuptim të nenit D të aneksit të Kushtetutës. Në të njëjtën kohë, për sa bëhet fjalë për transferta monetare nga jashtë vendit drejt Shqipërisë, nuk provohet mënyra e dërgesës në Shqipëri.

Në vlerësimin e Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi dhe pamjaftueshmëri në deklarime në DV-2003 dhe D-Vett., dhe gjatë shpjegimeve pas kalimit të barrës së provës, nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor justifikues, ndaj dhe pretendimet e tij mbeten në nivelin e deklarativ.

Subjekti i rivlerësimit, në të njëjtën kohë, nuk ka arritur të provojë përmbushjen e kërkesave të udhëzimit nr. 4095/2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, lidhur me mënyrën e

⁷Shpjegimet e datës ***** korrik 2018, faqe 8.

⁸ Shpjegimet e datës ***** mars 2018, faqe 3 dhe 4.

⁹ Shpjegimet e rezultateve të hetimit, f. 8.

¹⁰ Datë ****.10.2018*, faqe 12.

¹¹ Shpjegimet e datës ***** korrik 2018, faqe 14.

¹² Shpjegimet e datës ***** mars 2018, faqe 6.

¹³ Shpjegimet e datës ***** korrik 2018, faqe 8.

¹⁴ Shpjegimet e datës ***** korrik 2018, faqe 8.

transferimit të vlerave monetare nga jashtë vendit, që do të shërbente edhe për identifikimin e saktë të situatës faktike në funksion të justifikimit ligjor të burimit financiar.

5. Për burimin e krijimit të të ardhurave të ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e pasurive

5.1. Tri janë burimet e deklaruara të krijimit të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e pasurive të sipërcituara: *(i)* të ardhurat nga shitja e apartamentit në rrugën “****.***”¹⁵, Tiranë; *(ii)* të ardhurat personale dhe *(iii)* të ardhurat nga qiraja.

5.2. Subjekti i rivlerësimit deklaron si moment të përfundimit të investimit të pasurive në adresën rruga “****.***.***”, Tiranë, periudhën pranverë-verë 1999, ndaj dhe analiza financiare për burimin e krijimit të të ardhurave të ligjshme, që kanë shërbyer për krijimin e këtyre pasurive, shtrihet deri në këtë periudhë.

5.3. Lidhur me pasaktësitë dhe pamjaftueshmërinë në deklarime, Komisioneri Publik shprehet në analizën në vijim, për secilën pasuri:

5.3.1. Për pasurinë “Apartament banimi”, me sipërfaqe 293m², për të cilin subjektit të rivlerësimit, nga ana e Komisionit, i ka kaluar barra e provës për deklarim të pamjaftueshëm, të pasaktë dhe mungesë burimesh të mjaftueshme për të justifikuar pasurinë, konstatojmë se:

Në D-Vett., deklarohet vlera 5,800,000.00 lekë, burimi: (i) të ardhura personale dhe (ii) qira, ku për burimin “qira” subjekti deklaron¹⁶ se të ardhurat nga qiraja për vitet 2001-2006 janë bazuar në veprimet e bashkëpronares zj. ***.***.

Në DV-2003, deklarohet vlera 7,400,000.00 lekë, burimi: (i) nga shitja e apartamentit në rrugën “****.***” dhe (ii) të ardhura personale.

5.3.1/a. Lidhur me burimin e deklaruar “të ardhurat nga shitja e apartamentit”

(i) Nga aktet në dosje, si burim i ligjshëm, rezulton të jetë administruar kontrata e shitjes e datës *** janar 1999 (fotokopje e thjeshtë), për një transaksion në vlerën prej 3.950.000 lekë, për një pasuri së paluajtshme, apartament banimi, në rrugën “****.***” Tiranë, me palë shitëse 4 bashkëpronarët Zaganjori (subjekti i rivlerësimit, bashkëshortja dhe prindërit e tij) dhe palë blerëse z. ***.***. Nisur nga fakti që subjekti i rivlerësimit me bashkëshorten zotërojnë 2/4 pjesë takuese, nga aktet në dosje nuk arrihet të verifikohet kalimi i pjesës takuese të të ardhurave të realizuara nga shitja, nga prindërit te subjekti i rivlerësimit.

(ii) Nga korrespondenca e Komisionit me Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë¹⁷, rezulton se kjo pasuri, 20 vjet pas veprimit të lartpërmendur, vazhdon të jetë e regjistruar në pronësi të bashkëpronarëve Zaganjori, përfshirë subjektin e rivlerësimit. Sipas kartelës së pronësisë së kësaj pasurie, të datës ***.12.2017, në *Seksionin e Pronësisë*, datë e regjistrimit e titullit të pronësisë mbi këtë apartament, është data

¹⁵ Në DV-2003 deklarohet rruga “****.***”.

¹⁶ Në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”.

¹⁷ Shkresë nr. prot ***, datë ***.12.2017.

.1.2002, në emër të bashkëpronarëve Zaganjori. Bazuar në legjislacionin për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, regjistrimi i vitit 2002 në kartelën e pasurisë duhet të kryhet nga pronari ose përfaqësuesi i tij, në këtë rast bashkëpronarët Zaganjori. Këto rrethana të provuara janë në kontradiktë me kontratën e shitjes së datës *** janar 1999, për tjetërsimin e titullit të pronësisë së kësaj pasurie në emër të blerësit z. ***..

(iii) Subjekti i rivlerësimit, për të sqaruar situatën e titullit të pronësisë mbi këtë pasuri në momentin aktual, ka paraqitur vërtetim nga Njësia Administrative nr. ***, Bashkia Tiranë, si dhe vërtetim nga shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Tiranë, sipas të cilave z. ***.*** rezulton banor në këtë adresë dhe abonent i UKT-së, me cilësinë e poseduesit të objektit.

Në përfundim, për sa kohë titulli i pronësisë së këtij apartamenti vazhdon të jetë në emër të bashkëpronarëve Zaganjori, nuk arrihet në nivel të besueshëm (mbetet e paprovuar) ligjshmëria e burimit të të ardhurave nga kjo pasuri.

5.3.1/b. Lidhur me burimin e deklaruar “të ardhurat personale, deri në pranverë-verë 1999”

Subjekti i rivlerësimit, gjatë shpjegimeve në Komision, deklaroi se ka dhënë (i) shumën 2,500,000.00 lekë, në vitin 1996, znj. ***.***, si pjesë e të ardhurave për krijimin e pasurisë dhe (ii) në vitin 1999, shumën 1,000,000.00 lekë dhe 1,600,000.00 lekë.

(i) Për shumën prej 2,500,000.00 lekë, të paguar në vitin 1996, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për të vërtetuar burimin e krijimit të të ardhurave të ligjshme.

(ii) Për shumën prej 2,600,000.00 lekë, të paguar në vitin 1999, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacionin e të ardhurave të përfituara në formën e bursës për periudhën 1998 -1999, në ***.*** Institut, Heidelberg, sa më poshtë vijon:

- Vërtetim nga Dr. ***.***, në cilësinë e *kërkuesit të vjetër shkencor*, në ***.***-Institut, Heidelberg, i datës ***.10.2016, pa vulë apostile nga autoriteti përgjegjës dhe pa përkthim zyrtar në gjuhën shqipe;
- Vërtetim nga Z. ***.***, në cilësinë e *Drejtorit të mëparshëm të bibliotekës*, në ***.***-Institut, Heidelberg, i datës ***.7.2018, pa vulë apostile nga autoriteti përgjegjës dhe pa përkthim zyrtar në gjuhën shqipe;
- Vërtetim nga Z.***.***, në cilësinë e *Drejtorit të Personelit*, në ***.***-Institut, Heidelberg, i datës ***.7.2018, pa vulë apostile nga autoriteti përgjegjës dhe pa përkthim zyrtar në gjuhën shqipe;
- Fotokopje kalim pagese të bursës në favor të Dr. Xhezair Zaganjori dhe shtesë burse për bashkëshorten, për muajin qershor dhe korrik 1999, pa përkthim zyrtar në gjuhën shqipe.

5.3.1/b-1. Dokumentacioni i mësipërm ka mangësi nga ana formale, pasi është me origjinë nga një shtet i huaj dhe që të përdoret në vendin tonë duhet të legalizohet ose nga ambasada shqiptare në shtetin e huaj, ose të vuloset me vulë apostile¹⁸, nga autoriteti përgjegjës i huaj.

5.3.1/b-2. Për efekt të analizës financiare, të ardhurat e realizuara nga bursa e studimit në ***.***-Institut nuk mund të konsiderohen të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar kursimin/investimin e deklaruar, pasi bursa akordohet e llogaritur për të mbuluar shpenzimet e jetesës gjatë periudhës përkatëse dhe për këtë shkak dhe nuk tatohet. Në këtë analizë ligjore dhe financiare duhet mbajtur parasysh dhe fakti se subjekti i rivlerësimit, gjatë periudhës 1998-1999, ka jetuar në Gjermani së bashku me familjen, e përbërë nga katër anëtarë, gjë që ndikon edhe mundësinë eventuale të kursimit nga këto të ardhura burse.

5.3.1/b-3. Lidhur me sa më sipër trajtuar për bursën, tashmë ka një qëndrim të Kolegjit të Posaçëm të Apelit¹⁹, i cili bursën e akorduar gjatë studimeve e trajton si kuotë financiare për ushqim dhe shpenzime të tjera të vogla.

Në vlerësimin e Komisionerit Publik, nga analiza e akteve në dosje, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor justifikues për të vërtetuar kursimet e deklaruar, burimin e ligjshëm të të ardhurave të ligjshme, që kanë shërbyer për krijimin e këtyre kursimeve, si dhe prova/dokumentacion bankar apo jo bankar, për të vërtetuar mënyrën si këto shuma janë sjellë/dërguar në Shqipëri.

5.3.1/c Lidhur me burimin e deklaruar “të ardhurat nga qiraja”

5.3.1/c-1. Subjekti i rivlerësimit, në DV-2003, deklaroi po ashtu si burim krijimi të pasurisë “Apartament banimi”: (i) të ardhurat personale, ndërsa në D-Vett., përveç të ardhurave personale shton edhe (ii) të ardhurat nga qiraja. Po në D-Vett., subjekti deklaroi se, për periudhën 2001-2006, veprimet për lidhje kontrate qiraje dhe marrje pagese i ka kryer bashkëpronari tjetër, znj. ***.***. Gjatë hetimit administrativ të Komisionit, subjekti shpjegoi se të ardhurat nga qiraja për periudhën shtator 1997- dhjetor 1998 janë lënë si mbulim i shpenzimeve për pjesën takuese për ndërtimin e pallatit²⁰.

5.3.1/c-2. Nga aktet në dosje, rezultojnë të administruara:

(i) Kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme “Bibliotekë/dyqan”, e datës ***.10.2001, moment nga i cili subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij rezultojnë titullarë të së drejtës së pronësisë të pasurisë së paluajtshme, “Bibliotekë /dyqan”, me 2/8 pjesë takuese, e cila është dhënë me qira dhe nga ku janë gjeneruar të ardhurat.

(ii) *Deklaratë noteriale* e znj. ***.***., e datës ***.5.2016, e cila konfirmon deklarin e subjektit të rivlerësimit në Deklaratën Vetting për qiranë e periudhës 2001-2006.

¹⁸ Vendimi nr.9/2018, prg. 101.

¹⁹ Vendim i Kolegjit Posaçëm të Apelit nr. 9, datë 24.10.2018, paragrafi 81.

²⁰ Referohu përgjigjeve të pyetësorit datë ***.3.2018, f. 8.

(iii) Kontratë e datës ***.9.1997, me palë qiradhënës znj. ***.*** (si pronar i vetëm ligjor) dhe qiramarrës “***.***.***”, për sipërfaqen 250 m², me afat deri në *** gusht 2002.

5.3.1/c-3. Nga aktet më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij janë bashkëpronarë të pasurisë “Bibliotekë/dyqan”, me pjesë takuese 2/8, nga *** tetori 2001, data e fitimit të titullit të pronësisë përmes kontratës së shitjes. Për këtë arsye, të ardhurat nga qiraja për periudhën para kësaj date, në mungesë të aktit të pronësisë, marrëdhënies kontraktuale të qirasë dhe shlyerjes së detyrimeve tatimore, nuk konsiderohen si të ardhura të ligjshme, të gjeneruara nga një burim i ligjshëm për krijimin e pasurisë “Apartament banimi”.

Në përfundim, të ardhurat nga qiraja për këtë periudhë në mungesë të aktit të pronësisë, marrëdhënies kontraktuale të qirasë dhe shlyerjes së detyrimeve tatimore nuk mund të konsiderohen të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës.

5.3.2. Për pasurinë “Bibliotekë/dyqan”, me sipërfaqe 70 m², për të cilën, nga ana e Komisionit, subjektit të rivlerësimit i ka kaluar barra e provës për deklaram të pamjaftueshëm, të pasaktë dhe mungesë burimesh të mjaftueshme për të justifikuar pasurinë, konstatojmë se:

Në D-Vett., deklarohet vlera 1,400,000.00 lekë, burimi: (i) të ardhura personale dhe (ii) qira.

Në DV-2003, deklarohet vlera 1,800,000.00 lekë, burimi: (i) të ardhura personale.

5.3.2/a. *Lidhur me burimin e deklaruar “të ardhurat personale”, vlen arsyetimi sa më lart në pikën 5.3.1/b., pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor justifikues për të vërtetuar kursimet e deklaruara, burimin e ligjshëm të të ardhurave që ka shërbyer për krijimin e të ardhurave të ligjshme, si dhe prova/dokumentacion bankar apo jo bankar, për të vërtetuar mënyrën si këto shuma janë sjellë/dërguar në Shqipëri.*

5.3.2/b. *Lidhur me burimin e deklaruar “të ardhurat nga qiraja”, shtuar si burim në D-Vett., vlen arsyetimi sa më lart në pikën 5.3.1/c, ku bazuar në mungesën e aktit të pronësisë, marrëdhënies kontraktuale të qirasë dhe shlyerjes së detyrimeve tatimore, të ardhurat nga qiraja, nuk mund të konsiderohen të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3, e aneksit të Kushtetutës. Lidhur me këtë deklaram, konstatohet nonsens logjik lidhur me burimin financiar për krijimin e pasurisë “Bibliotekë/dyqan”²¹, i cili nga njëra anë paraqitet si pasuri, nga e cila gjenerohen të ardhura dhe po këto të ardhura shërbejnë për krijimin e saj.*

5.3.3. Për pasurinë “Bodrum”, me sipërfaqe 65 m², për të cilin subjektit të rivlerësimit, nga ana e Komisionit, i ka kaluar barra e provës për deklaram të pamjaftueshëm, të pasaktë dhe mungesë burimesh të mjaftueshme për të justifikuar pasurinë, konstatojmë se:

Në D-Vett., deklarohet vlera 800,000.00 lekë, burimi: (i) të ardhura personale dhe (ii) qira.

²¹ Emërtimi në DV 2003 dhe D-Vett.

Në DV- 2003, deklarohet vlera 1,500,000.00 lekë (e deklaruar bashkë me pasurinë “Zyrë”, 20 m²), burimi: të ardhura nga qiraja e bibliotekës.

5.3.3/a. Lidhur me burimin e deklaruar “të ardhurat personale”, vlen arsyetimi sa më lart në pikën 5.3.1/b., pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor justifikues për të vërtetuar kursimet e deklaruara, burimin e ligjshëm që ka shërbyer për krijimin e të ardhurave të ligjshme, si dhe prova/dokumentacion bankar apo jobankar, për të vërtetuar mënyrën si këto shuma janë sjellë/dërguar në Shqipëri.

5.3.3/b. Lidhur me burimin e deklaruar “të ardhurat nga qiraja”, vlen arsyetimi sa më lart në pikën 5.3.1/c., ku bazuar në mungesën e aktit të pronësisë, marrëdhënies kontraktuale të qirasë dhe shlyerjes së detyrimeve tatimore, të ardhurat nga qiraja, nuk mund të konsiderohen të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3, e aneksit të Kushtetutës.

5.3.4. Për pasurinë “Zyrë”, me sipërfaqe 15 m², për të cilën, nga ana e Komisionit, subjektit të rivlerësimit i ka kaluar barra e provës për deklarim të pamjaftueshëm, të pasaktë dhe mungesë burimesh të mjaftueshme për të justifikuar pasurinë, konstatojmë se:

Në D-Vett., deklarohet vlera 400,000.00 lekë, burimi: (i) të ardhura personale dhe (ii) qira.

Në DV-2003, deklarohet vlera 1,500,000.00 lekë (e deklaruar bashkë me pasurinë “Bodrum”, 70 m²), burimi: (i) të ardhura nga qiraja e bibliotekës.

5.3.4/a. Lidhur me burimin e deklaruar “të ardhurat personale”, vlen arsyetimi sa më lart në pikën 5.3.1/b., pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor justifikues për të vërtetuar kursimet e deklaruara, burimin e ligjshëm që ka shërbyer për krijimin e të ardhurave të ligjshme, si dhe prova/dokumentacion bankar apo jo bankar, për të vërtetuar mënyrën si këto shuma janë sjellë/dërguar në Shqipëri.

5.3.4/b. Lidhur me burimin e deklaruar “të ardhurat nga qiraja”, vlen arsyetimi sa më lart në pikën 5.3.1/c., ku bazuar në mungesën e aktit të pronësisë, marrëdhënies kontraktuale të qirasë dhe shlyerjes së detyrimeve tatimore, të ardhurat nga qiraja nuk mund të konsiderohen të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3, e aneksit të Kushtetutës.

Në përfundim, në vlerësimin e Komisionerit Publik, për pasuritë: (i) “Apartament banimi”; (ii) “Bibliotekë/dyqan”; (iii) “Bodrum”; (iv) “Zyrë”, në referencë të nenit D, pika 3 dhe 5, të aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për vlerën e deklaruar në D-Vett. dhe DV-2003; ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për vlerat e deklaruara (fatura/preventiv/situacion), ka mungesë burimi të ligjshëm për krijimin e të ardhurave të ligjshme, që kanë shërbyer për krijimin e pasurive në vlerën 10,700,000.00 lekë.

6. Të ardhurat nga qiratë ndër vite

Subjekti i rivlerësimit në D-Vett. dhe në Deklarimet periodike vjetore 2003-2016 ka deklaruar të ardhura nga qiratë e ambienteve “Bibliotekë/dyqan”, “Zyrë”, “Bodrum” në adresën rruga

“***.***.***”, Tiranë. Këto të ardhura janë deklaruar se kanë shërbyer si burim për krijimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme²². Në vijim trajtohen të ardhurat nga qiratë për periudhën 1999-2007, për të cilat subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për t’u konsideruar si të ardhura të ligjshme.

6.1. Të ardhurat nga kontrata me qiramarrës “*.***.***”, për të cilat subjektit të rivlerësimit i ka kaluar barra e provës për deklarim të pamjaftueshëm dhe të pasaktë**

6.1.1. Për të ardhurat e deklaruara, për periudhën 1997-2006, ku qiramarrës deklarohet “***.***.***”, periudha 1997-1998 është trajtuar në pikën 5.3.1/c., ndërsa periudha 1999- 2006 analizohet në vijim:

6.1.1/a. Periudha **janar 1999 - tetor 2001**. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se të ardhurat nga qiraja i ka përfituar që nga janari 1999. Në analizë ligjore të akteve rezulton se: (i) akti i pronësisë në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, për këtë objekt të dhënë me qira, është i datës *** tetor 2001; (ii) kontrata e qirasë është nënshkruar në cilësinë e qiradhënësit nga znj.***.***. (si pronare e vetme); (iii) subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e datës ***.3.2018²³ deklaroi se pagesa e tatimit mbi të ardhurat nga qiraja për të gjithë periudhën deri në vitin 2006 është kryer nga znj. ***.***.

Në referencë të vërtetimit të pagesës së detyrimeve tatimore, dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit për shlyerjen e këtyre detyrimeve për periudhën në fjalë, janë disa *mandate bankare*, me përshkrimin “*tatim mbi qiranë, familja ****”, paguar nga llogaria e shoqërisë “***.***”, sh.p.k. Në shoqërinë “***.***” sh.p.k. znj. ***.*** nuk paraqitet në ndonjë cilësi si administratore/ortake/përfaqësuese ligjore, fakt që mund të çonte në hamendësimin se nga llogaria e një subjekti tregtar znj. ***.*** të kishte kryer pagesa private. Në këto rrethana, të ardhurat nga qiraja për këtë periudhë nuk mund të konsiderohen të ardhura të ligjshme të krijuara nga burime të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3, e aneksit të Kushtetutës, pasi: (i) subjekti i rivlerësimit nuk rezulton me titull pronësie për objektin e dhënë me qira, (ii) nuk rezulton palë kontraktuese në kontratën e qirasë dhe (iii) nuk provon me dokumentacion ligjor justifikues shlyerjen e detyrimeve tatimore për të ardhurën e deklaruar në shumën **23,760.00 USD (neto)**.

6.1.1/b. Periudha **tetor 2001 - shkurt 2003**. Gjatë kësaj periudhe, subjekti i rivlerësimit gëzon titullin e pronësisë mbi objektin e dhënë me qira. Në kontratën e qirasë, në cilësinë e qiradhënësit është znj. ***.*** (si pronare e vetme). Në shkurt 2003 është hartuar *Prokura e posaçme*, sipas së cilës znj. ***.*** vepron në llogari të bashkëpronarëve për dhënien me qira të ambienteve. Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e datës ***.3.2018²⁴ deklaroi se pagesa e tatimit mbi të ardhurat nga qiraja për të gjithë periudhën deri në vitin 2006 është kryer nga znj. ***.***. Dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit për shlyerjen e detyrimeve tatimore për këtë periudhë është *nxjerrje llogarie*, e shoqërisë “***.***” sh.p.k., pranë Bankës ***, ku evidentohen veprimet (vetëm për vitin 2002) me përshkrimin “*tatim mbi qiranë, familja ****”. Në shoqërinë “***.***” sh.p.k., znj.***.*** nuk paraqitet në ndonjë cilësi si administratore/ortake/përfaqësuese

²² Shpjegimet e datës *** mars 2018, faqe 3.

²³ Faqe 3.

²⁴ Faqe 3.

ligjore, fakt që mund të çonte në hamendësimin se nga llogaria e një subjekti tregtar znj. ***.*** të kishte kryer pagesa private. Në këto rrethana, të ardhurat nga qiraja për këtë periudhë nuk mund të konsiderohen të ardhura të ligjshme të krijuara nga burime të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, pasi subjekti i rivlerësimit: (i) nuk rezulton palë kontraktuese në kontratën e qirasë dhe (ii) nuk provon me dokumentacion ligjor justifikues shlyerjen e detyrimeve tatimore për të ardhurën e deklaruar në shumën **11,520.00 USD (neto)**.

6.1.1/c. Periudha shkurt **2003 - dhjetor 2005**. Për këtë periudhë, subjekti i rivlerësimit gëzon titullin e pronësisë mbi objektin e dhënë me qira dhe znj. ***.*** ka tagër për të vepruar në emër të bashkëpronarëve. Subjekti në shpjegimet e datës ***.3.2018 deklaroi se pagesa e tatimit mbi të ardhurat nga qiraja për të gjithë periudhën deri në vitin 2006 është kryer nga znj. ***.***. Dokumentacioni i paraqitur nga subjekti për shlyerjen e detyrimeve tatimore për këtë periudhë janë dy urdhërtransferta të shoqërisë “***.***” sh.p.k., njëra e datës ***.12.2004, sipas të cilës nga llogaria e shoqërisë paguhet “tatimi për 6-mujorin e dytë të vitit 2004 dhe gjashtëmujorin e parë të vitit 2005”, dhe tjetra e datës ***.12.2005 sipas të cilës nga llogaria e shoqërisë “paguhet tatimit për 6-mujorin e dytë të vitit 2005”. Në shoqërinë “***.***” sh.p.k. znj. ***.*** nuk paraqitet në ndonjë cilësi si administratore/ortake/përfaqësuese ligjore, fakt që mund të çonte në hamendësimin se nga llogaria e një subjekti tregtar znj. ***.*** të kishte kryer pagesa private. Në këto rrethana, të ardhurat nga qiraja për këtë periudhë nuk mund të konsiderohen të ardhura të ligjshme të krijuara nga burime të ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, pasi subjekti i rivlerësimit nuk provon me dokumentacion ligjor justifikues shlyerjen e detyrimeve tatimore për të ardhurën e deklaruar në shumën **25,200.00 USD (neto)**.

6.2. Të ardhurat nga kontrata me qiramarrës “*.***”, për të cilat subjektit të rivlerësimit i ka kaluar barra e provës për deklarim të pamjaftueshëm dhe të pasaktë**

6.2.1 Për vitin **2007**, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga qiraja në shumën 1,200.00 euro në DV- 2007 dhe 742 euro në D-Vett. Nga aktet në dosje, rezulton e administruar kontrata e datës ***.5.2007, me palë qiradhënës z. ***.*** (si pronar i ligjshëm) dhe qiramarrës “***.***”, për sipërfaqen 100 m², me afat tremujor + dy muaj. Objekti i dhënë me qira nuk identifikohet se cilën prej pasurive në bashkëpronësi të subjektit përfaqëson. Për sa kohë që subjekti i rivlerësimit nuk është palë në kontratë dhe nuk mund të identifikohet qartë pasuria e dhënë me qira, të ardhurat e realizuara nga kjo marrëdhënie nuk mund konsiderohen të ardhura të ligjshme të subjektit të rivlerësimit.

6.3. Të ardhurat nga kontrata me qiramarrës “*.***” sh.p.k., për të cilat subjektit të rivlerësimit i ka kaluar barra e provës për deklarim të pamjaftueshëm dhe të pasaktë**

6.3.1 Periudha **2005 - 2006**. Nga aktet në dosje rezultojnë kontrata të nënshkruara si qiradhënës bashkëpronarët Zaganjori, *** dhe qiramarrës “***.***” sh.p.k., për pasuritë “Bodrum” dhe “Zyrë”. Dokumentacioni i paraqitur nga subjekti për shlyerjen e detyrimeve tatimore është vetëm një vërtetim (shkresë) i shoqërisë “***.***” sh.p.k., datë ***.4.2016, sipas të cilës janë shlyer detyrimet tatimore prej kësaj shoqërie për këtë periudhë. Në këto rrethana, të ardhurat nga qiraja për këtë periudhë nuk mund të konsiderohen të ardhura të ligjshme të krijuara nga burime të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, pasi subjekti i rivlerësimit nuk

provon me dokumentacion ligjor justifikues shlyerjen e detyrime tatimore për të ardhurat e deklaruar në shumat 4,800.00 USD dhe 2,160.00 euro.

6.3.2. Për vitin 2007. Subjekti i rivlerësimit deklaroi të ardhura nga qiraja nga shoqëria “***.***” sh.p.k., por nuk rezultoi të ketë paraqitur kontratën përkatëse. Dokumentacioni i paraqitur nga subjekti për shlyerjen e detyrimeve tatimore është vetëm një *vërtetim* (shkresë), i shoqërisë “***.***” sh.p.k., me datë ***.4.2016, sipas të cilit janë shlyer detyrimet tatimore prej kësaj shoqërie, për këtë periudhë. *Në këto rrethana, të ardhurat nga qiraja për këtë periudhë nuk mund të konsiderohen të ardhura të ligjshme të krijuara nga burime të ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, pasi subjekti i rivlerësimit nuk provon me dokumentacion ligjor justifikues marrëdhënien kontraktuale dhe shlyerjen e detyrimeve tatimore për të ardhurat e deklaruar në shumën 270,000.00 lekë.*

Në përfundim, në vlerësimin e Komisionerit Publik, referuar nenit D, pika 3 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm dhe nuk ka provuar me dokumentacion justifikues ligjor të ardhurat e ligjshme nga qiratë, për shumën totale prej rreth 8,4 milionë lekë²⁵.

7. Pasuria në * , plazh, Durrës**

7.1. Për pasurinë “Apartament”, me sipërfaqe 81 m², *, plazh Durrës, për të cilin subjektit të rivlerësimit, nga ana e Komisionit, i ka kaluar barra e provës për deklaram të pamjaftueshëm, të pasaktë dhe mungesë burimesh të mjaftueshme për të justifikuar pasurinë, konstatojmë se:**

Në D-Vett., deklarohet vlera 32,000 USD dhe burimi i krijimit: (i) të ardhura personale dhe (ii) qira.

Në DV-2006, deklarohet vlera 32,000 USD pa specifikuar burimin e krijimit. Po në atë deklaratë parashtrohet dhe një veprim i kryer nga subjekti: *“tërheqje dhe mbyllje e llogarisë bankare në Bankën ***.*** në maj të vitit 2006, për shumën 1.250.000 lekë.”*

7.1.1. Nga aktet në dosje, rezultoi e administruar kontrata e shitjes e datës ***.6.2006, me palë shitëse shoqëria “***” sh.p.k. dhe palë blerëse subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja, për një çmim 32,000 USD, të likuiduar jashtë zyrës noteriale.

7.1.2. Për shumën 32,000 USD, subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e datës *** mars 2018,²⁶ ka referuar se pjesa më e madhe e kësaj shume, prej rreth 16.000 USD, është tërhequr nga depozita e përbashkët me bashkëshorten në Bankën ***.***.*** (tani ***.***.***), si dhe tërheqja dhe mbyllja e llogarisë në lekë, në shumën 1,250,000.00 lekë nga Banka ***.*** ka shërbyer po ashtu për pagesën e çmimit të blerjes.

Si burim për krijimin e këtyre depozitave, nga subjekti deklarohen: (i) të ardhurat nga qiratë (të trajtuara më sipër) dhe (ii) të ardhurat nga pagat. Lidhur me të ardhurat nga pagat e bashkëshortes,

²⁵ Shumat e evidentuara më sipër, konvertuar sipas viteve me kurset mesatare përkatëse (marrë nga “Arkiva e kursit të këmbimit” Banka e Shqipërisë), respektivisht 60, 480 USD nga “***.***.***”; 4,800 USD, 2,160 euro dhe 270.000 lekë nga “***.***” sh.p.k.; dhe 1,200 euro nga: “***”.

²⁶ Faqe 12.

subjekti i rivlerësimit ka paraqitur *vërtetimin* (shkresë), të datave *** tetor 2016 dhe datës ***.7.2018 të shoqërisë “***.***” sh.p.k., sipas të cilave bashkëshortja e subjektit, për periudhën e punësimit ***.8.1999 - ***.6.2005, ka përfituar pagën neto 1,347,080 lekë dhe për periudhën e punësimit ***.8.1999 - ***.12.2002 bashkëshortja e subjektit ka përfituar pagën neto 429.421 lekë. Për këto të ardhura, subjekti i rivlerësimit nuk provon me dokumentacion ligjor justifikues pagesën e detyrimeve tatimore.

7.1.3. Lidhur me burimin e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, tërheqje e depozitës në shumën 16,000 USD, nga korrespondenca e Komisionit me ***.***.*** Bank, ky transaksion në vitin 2006 nuk konfirmohet që të jetë kryer, sipas dokumentacionit bankar.

Në përfundim, në vlerësimin e Komisionerit Publik, referuar nenit D, pika 3 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës, subjekti ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm dhe ka mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, përderisa nuk konfirmohet tërheqja e shumës prej 16,000 USD dhe pagesa e detyrimeve tatimore për të ardhurat e pretenduara nga marrëdhënia e punësimit e bashkëshortes.

8. Shpenzimet e shkollimit dhe jetesës të personave të lidhur, z. *.*** dhe ***.***,** për të cilat subjekti të rivlerësimit, nga ana e Komisionit, i ka kaluar barra e provës për deklaram të pamjaftueshëm, të pasaktë dhe se ka mungesë burimesh të mjaftueshme për të justifikuar shpenzimet, konstatojmë se:

8.1 Lidhur me personin e lidhur (djali) z. *.***.**

(i) Në deklaratat periodike vjetore, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në seksionin e ndryshimeve të pasurisë, pagesat e kryera për shkollimin e personit të lidhur (djali) ***.***, duke filluar nga DV- 2008.

(ii) Në DV-2008, subjekti deklaroi pagesë në shumën 9,400 PAUND, ndërkohë në shpjegimet e datës *** mars 2018, për vitin 2008, subjekti i rivlerësimit deklaroi një vlerë të ndryshme, përkatësisht shumën 7,000 PAUND, pagese shkolle dhe 4,000 PAUND, për mbulimin e shpenzimeve të jetesës.

(iii) Në DV-2010, subjekti deklaroi pagesë në shumën 12,500 PAUND, ndërkohë në shpjegimet e datës *** mars 2018, për vitin 2010, subjekti i rivlerësimit deklaroi një vlerë të ndryshme, përkatësisht shumën 17, 386 PAUND.

(iv) Në DV-2011, subjekti deklaroi pagesë në shumën 13,200 PAUND, ndërkohë në shpjegimet e datës *** mars 2018, për vitin 2011, subjekti i rivlerësimit deklaroi një vlerë të ndryshme, përkatësisht shumën 20,565 PAUND.

8.1.1. Rezulton se subjekti në deklaramet periodike vjetore dhe gjatë procesit të hetimit administrativ ka bërë deklaram të pasaktë për vlerat e shpenzimeve të shkollimit dhe jetesës për personin e lidhur (djali) z. ***.*** në universitet, në Londër.

8.1.2. Nga aktet në dosje, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për të provuar kostot/shpenzimet e shkollimit dhe jetesës për periudhën 2008-2013, dhe shpjegimet e tij mbeten në nivelin e pretendimeve të paprovuara.

8.2. Lidhur me personin e lidhur (djali) z. *.***.**

(i) Në deklaratat periodike vjetore, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në seksionin e ndryshimeve të pasurisë, pagesat e kryera për shkollimin e personit të lidhur (djali) ***.***, duke filluar nga DV-2013.

(ii) Në DV-2014, subjekti deklaroi pagesë në shumën 9,000 euro, ndërkohë nga verifikimi i llogarisë bankare të tij pranë *** Bank, për vitin 2014, rezulton se janë kryer dy transferta me jashtë, në datat ***.1.2014 dhe ***.09.2014, në shumën totale 12,023.57 euro, që sipas përshkrimit²⁷ lidhen me shkollimin e të birit në Gjermani.

8.2.1. Rezulton se subjekti në deklaratat periodike vjetore dhe gjatë procesit të hetimit administrativ ka bërë deklaratim të pasaktë për vlerat e shpenzimeve të shkollimit dhe jetesës për personin e lidhur (djali) ***.***., në universitet, në Gjermani.

8.2.2. Nga aktet në dosje, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për të provuar kostot/shpenzimet e shkollimit dhe jetesës për periudhën 2013-2016, dhe shpjegimet e tij mbeten në nivelin e pretendimeve të paprovuara.

Në përfundim, në vlerësimin e Komisionerit Publik, referuar nenit D, pika 3 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaratim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, dhe ka mungesë burime të ligjshme për të justifikuar shpenzimet e shkollimit dhe jetesës të personave të lidhur, *.*** dhe ***.***. Nga analiza financiare e të ardhurave dhe shpenzimeve të subjektit të rivlerësimit për këto vite, ka rezultuar se subjekti nuk mbulon me burime të ligjshme shpenzimet dhe kursimet për periudhën 2011-2014.²⁸**

9. Të ardhurat e viteve 2011, 2012, 2014, për të cilat subjektit të rivlerësimit, nga ana e Komisionit, i ka kaluar barra e provës për deklaratim të pamjaftueshëm, të pasaktë dhe mungesë burimesh të mjaftueshme për të justifikuar shpenzimet dhe kursimet, konstatohet se:

9.1. Nga analiza e të ardhurave dhe shpenzimeve të subjektit të rivlerësimit për vitet 2011, 2012, 2014, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk justifikon me burime të ligjshme të ardhurash shpenzimet dhe kursimet respektivisht: (i) për vitin 2011, në shumën prej 189,647.22 lekë; (ii) për vitin 2012, në shumën prej 1,372,389.92 lekë; dhe (iii) për vitin 2014, në shumën prej 891,772.31 lekë.

Në përfundim, në vlerësimin e Komisionerit Publik, referuar nenit D, pika 3 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës, rezulton se, për këto vite, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaratim të pasaktë, të pamjaftueshëm dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të mbuluar shpenzimet dhe kursimet, për një total diferencë negative për këto vite, prej 2.453.809 lekë.

²⁷ Me përshkrim veprimi: “***.*** RENT dhe PAYM FOR STUDY”.

²⁸ Për më tepër, referohu pikës 8.

10. Konkluzione

Nga sa analizuar më sipër, në vlerësim të Komisionerit Publik, rezulton se:

I. Për pasuritë (i) “Apartament banimi”, (ii) “Bibliotekë/dyqan”, (iii) “Bodrum”, (iv) “Zyrë”, referuar nenit D, pika 3 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit ka deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për vlerën e deklaruar në D-Vett. dhe DV-2003, ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për vlerat e deklaruar (fatura/preventiv/situacion), ka mungesë burimi të ligjshëm të krijimit të të ardhurave të ligjshme, që kanë shërbyer për krijimin e pasurive në vlerën 10,700,000.00 lekë.

II. Për të ardhurat nga qiratë, referuar nenit D, pika 3 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, dhe nuk ka provuar me dokumentacion justifikues ligjor të ardhurat e ligjshme nga qiratë, për shumën totale prej rreth 8,4 milionë lekë²⁹.

III. Për pasurinë “Apartament, *, plazh Durrës”,** referuar nenit D, pika 3 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të pamjaftueshëm dhe të pasaktë, dhe ka mungesë të burimeve të ligjshme të krijimit të kësaj pasurie.

IV. Për shpenzimet e shkollimit dhe jetesës së personave të lidhur, z. ***,*** dhe ***,***, referuar nenit D, pika 3 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, dhe ka mungesë të burimeve të ligjshme, të të ardhurave të ligjshme për të justifikuar shpenzimet e shkollimit dhe jetesës.

V. Për të ardhurat e viteve 2011, 2012 dhe 2014, referuar nenit D, pika 3 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës, rezulton se subjekti i rivlerësimit për këto vite ka bërë deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të mbuluar shpenzimet dhe kursimet për një total diference negative për këto vite, prej 2.453.809 lekë.

Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, nenit, C/2, Ç, D dhe F/7 të aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa disponon Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për kriterin e pasurisë, referuar gjendjes së fakteve dhe provave, nuk krijohet bindja se subjekti i rivlerësimit ka arritur të argumentojë burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurave të tij me qëllim arritjen e një niveli të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, sipas nenin 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

Bazuar në nenin D dhe F, të aneksit të Kushtetutës, nenet 30-34 dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, kërkojmë që shkaqet e ankimit të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe, mbështetur në parashikimet e nenit F, pika 3 dhe 7 e aneksit të Kushtetutës, nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, Kolegji i Posaçëm i Apelit të vendosë:

²⁹ Shumat e evidentuara më sipër, konvertuar sipas viteve me kurset mesatare përkatëse (marrë nga “Arkiva e kursit të këmbimit” Banka e Shqipërisë), respektivisht 60,480 USD nga “***.***.***”; 4,800 USD, 2,160 euro dhe 270.000 lekë, nga “***.***” sh.p.k., dhe 1,200 euro nga “***.***”.

- Ndryshimin e vendimit nr. 46, datë 24.7.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, zotit Xhezair Zaganjori.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA